

UDHËZIME PËR PJESËMARRJE NË PARLAMENTIN E IV RURAL SHQIPTAR

Europa në Shqipërinë Rurale: Shqipëria rurale në rrugën drejt BE-së nëpërmjet partneriteteve, reformës dhe zhvillimit territorial koheziv

Bashkitë pritëse: Bashkia e Lezhës dhe Bashkia e Mirditës

25-27 mars 2026

Konteksti dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve

Parlamenti IV Rural Shqiptar do të mbledhë një numër të kufizuar pjesëmarrësish që përfaqësojnë aktorë të ndryshëm nga i gjithë territori i Shqipërisë, përfshirë fermerë, përfaqësues të sektorit privat, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të 61 bashkive të vendit dhe institucioneve publike në nivel kombëtar, të rinj dhe dhe aktorë të tjerë të zhvillimit vendor.

Pjesëmarrësit do të përzgjidhen përmes formularit të regjistrimit, me qëllim garantimin e një përfaqësimi të balancuar territorial dhe përputhshmërisë me objektivat e Parlamentit Rural Shqiptar.

Pas përfundimit të afatit të regjistrimit, pjesëmarrësit do të kontaktohen për t'iu konfirmuar pjesëmarrjen dhe informacionet e detajuara mbi organizimin dhe logjistikën.

Ushqimi dhe akomodimi

- Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Parlamentit, në përputhje me draft Programin e Parlamentit do të ofrohen pushime kafeje, pije freskuese dhe vakte ushqimore, të siguruara nga organizatorët.
- Akomodimi do të ofrohet vetëm për pjesëmarrësit që vijnë nga zona të tjera, duke përjashtuar bashkitë fqinje në zonë.
- Akomodimi do të organizohet në dhoma hoteli teke, dyshe ose të përbashkëta), në varësi të disponueshmërisë dhe kapaciteteve logjistike.
- Mbulimi me akomodim do të jetë prioritet për përfaqësuesit e sektorit jo-publik, duke përfshirë përfaqësues të shoqatave, të rinjve, sipërmarrjeve etj.

- Organizatorët nuk ofrojnë akomodim për përfaqësuesit e institucioneve publike.
- Akomodimi nuk do të ofrohet për pjesëmarrësit që banojnë në ose pranë bashkive pritëse, përfshirë Lezhë, Rrëshen, Kurbin dhe zonat përreth.

Kostot e transportit

Kostot e transportit nuk mbulohen nga organizatorët, pavarësisht nga sektori dhe përfaqësimi. Të gjithë pjesëmarrësit janë përgjegjës për mbulimin e shpenzimeve të tyre të udhëtimit vajtje-ardhje drejt Lezhë dhe Mirditës, sipas rastit, përfshirë ata që vijnë nga zona të largëta apo bashki të afërta.

Pjesëmarrja në aktivitetin territorial më 25 mars

Parlamenti Rural Shqiptar do të nisë më 25 mars, në kuadër të aktivitetit hapës:

“Sinergjitë Territoriale për Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti (Qasja LEADER)”. Pjesëmarrja në këtë aktivitet rekomandohet për aktorët nga bashkitë Mirditë dhe Lezhë, ndërkohë që mbetet e hapur edhe për pjesëmarrës të tjerë të përzgjedhur, në varësi të relevancës dhe disponueshmërisë.

Kodi i Sjelljes

- Të gjithë pjesëmarrësit pritët të ndjekin rregullisht sesionet përgjatë programit, të angazhohen aktivisht në diskutime dhe të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në aktivitetet në grup gjatë gjithë Parlamentit.
- Pjesëmarrësit duhet të demonstrojnë sjellje profesionale duke kontribuar në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës që vlerëson diversitetin e perspektivave dhe bashkëpunimin.
- Duke konfirmuar pjesëmarrjen, pjesëmarrësit bien dakord të respektojnë agjendën e aktivitetit, organizimin logjistik dhe çdo udhëzim të komunikuar nga organizatorët.
- Organizatorët rezervojnë të drejtën për të bërë përshtatje të nevojshme në agjendë, logjistikë apo organizimin e pjesëmarrjes, me qëllim garantimin e një zbatimi efektiv dhe të suksesshëm të Parlamentit.